



01.07.2020

02/227



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

RREGULLORE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE

MALISHEVË

2020

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 pika c, nenit 17, nenit 24 paragrafi 2, nenit 40 paragrafi 2 pika a, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, qershor 2008), nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008), nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008”), nenit 36, paragrafi 3 të Rregullores Financiare Nr. 01/2013 - MF-Shpenzimi i parave publike, në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 pika e, nenit 37, nenit 38, të Statutit të Komunës së Malishevës nr. 01/871 të datës 12.11.2008, vendimin nr.02/178 datë: 03.06.2020, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.06.2020 miraton:

RREGULLOREN PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës- fondi për subvencione dhe transfere për ndihmë materiale, personave fizik dhe juridik.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të subvencioneve dhe transfereve për vitin aktual, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndanë mjete financiare buxhetore- ndihmë momentale, për personat juridik dhe fizik sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.
3. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Me këtë Rregullore, përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik.
2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit.

Neni 3

Përkufizimet

1. Përveç përkufizimeve të përcaktuara me ligjet tjera përkatëse, përkufizimet e cekura më poshtë e kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Subvencionet**- përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në llogarinë rrjedhëse, ndërsa transferet janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për qeveritë tjera, institucionet joprofitabile, familje dhe individëve.
 - 1.2 **Pagesa e pakthyeshme**- është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesë.
 - 1.3 **Përfituesit**- nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e komunës.
 - 1.4 **Banor rezident**- nënkupton personin që jeton në komunë dhe posedon dokumentacionin valid të Republikës së Kosovës.
 - 1.5 **Komision**- nënkupton komisionin e emëruar nga Kryetari i Komunës për vlerësimin e kërkesave të parashtruara për subvencionim.

Neni 4

Limitet buxhetore

1. Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar më këtë ligj.
2. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës.
2. Kërkesa duhet të jetë e qartë, e arsyetuar dhe objektivisht e realizueshme.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Kuvendi Komunal.
4. Kryetari komunës aprovon ndarjen e subvencioneve deri në këto limite për persona fizik dhe juridik në vlerë deri në 500 euro.
5. Nëse subvencionimi financiar ka të bëjë me shuma më të mëdha që është përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni për të njëjtin vendos kuvendi komunal.

Neni 6

Proceduar e përgjithshme për ndarjen e subvencionit

1. Proceduara e ndarjes së subvencioneve nga Komuna zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike, apo në raste të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar nga personi fizik ose juridik, atëherë kur lejohet dispozita e kësaj rregulloreje.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohen qartë fusha dhe lloji i subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informatat tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara me nenin 15 të kësaj rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarjen e subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 7

Përfjashtimet nga ndarja e subvencioneve

1. Personat jorezident në Komunën e Malishevës nuk mund të jenë përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna e Malishevës.
2. Personi fizik dhe juridik vetëm njëherë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përfjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë subvencionet e ndara për personat fizik në fushën shëndetësisë dhe për nevoja ushqimore (mirëqenie sociale).
4. Nëse me fajin e përfituesit nuk përbushën obligimet e përcaktuara në vendimin apo në marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve 2 vitet e ardhëshme përfituesi humbë të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 8

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fusha specifike.
2. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet të përgjithshme të ligjshmërisë dhe dispozitave ligjore në fuqi.
3. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil dhe nga shoqëria civile.
4. Përbërja e Komisionit duhet të jetë prej 3 anëtarëve, një nga anëtarët e komisionit duhet të jetë zyrtar i financave, një anëtar profesionist nga drejtoria (fusha) përkatëse

që ndahet subvencioni, një anëtar nga shoqëria civile (sindikata, OJQ, individ profesional të fushave të caktuara) që zgjidhet përmes shpelljes publike dhe që për angazhimin e tij kompenzohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

5. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
6. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

Neni 9

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrjes

1. Komisioni bënë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, pas përfundimit të afatit të shpalljes publike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe legjislacionin në fuqi.
3. Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve bëhet sipas kriterëve të vendosura në shpalljen publike dhe sipas formularit të vlerësimit i bashkangjitur në ankesin 1 të kësaj rregulloreje.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe anëtarët e Komisionit.
5. Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe rekomandon marrjen e Vendimit për ndarjen e subvencioneve.
6. Lista e nxjerrë nga Komisioni për vlerësim duhet të përmbajhtë dhënat e mëposhtme:
 - emrin dhe mbiemrin e përfituesit të subvencionot
 - vendbanimin, (fshatin)
 - vlerësimin për secilin kriter dhe piket e fituara në listën e përgjithshme të fituesve
 - listën e të gjithë aplikuesve dhe ndarjen sipas vlerësimit.
7. Kryetari i Komunës e aprovon apo e refuzon listen e Komisionit vlerësues dhe nuk ka të drejtë të ndërhy për të shtuar persona tjerë në listë.
8. Kryetari merr VENDIM për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit, në afat prej 5 ditë pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuara sipas neni 10 të kësaj rregulloreje.
9. Të gjithë aplikuesit që nuk kanë arritur të plotësojnë kriteret e nevojshme për të përfituar subvencionin, në afat prej 15 ditësh kanë të drejtë në paraqitjen e ankesës tek komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave.

Neni 10

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat katër (4) vjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga: një jurist, një anëtar nga drejtoria e financave dhe një anëtar nga drejtoria apo fusha përkatëse në të cilën ndahet subvencioni.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil.
3. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve.
4. Komisioni mbanë procesverbalin nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit.
5. Një anëtar i komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor.
6. Anëtar të komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
7. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

Neni 11

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

1. Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara ndanë ndihmë momentale nga fondi për transfere dhe subvencione të Komunës, për raste urgjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, varfëri të skajshme, për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm.
2. Aknesa parashtrihen në afat prej 5 ditë pune pasë njoftimit të vendimit të Kryetarit të Komunës për mos ndarjen e subvencioneve.
3. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 15 ditë pune pasë përfundimit të afatit kohorë për paraqitje të ankesave.

Neni 12

Subvencionet për individ dhe familje

1. Kryetari i Komunës, lejon ndarjen e subvencioneve për persona dhe familjet në nevojë si ndihmë materiale për përkujdesje sociale dhe shëndetësore, shumë e cila mund të jetë deri në 500 euro.
2. Ndihma materiale e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, nënkupton sigurimin e të hollave, ushqimit apo kompensimin e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje.
3. Komiteti për Politikë dhe Financa KPF, mundë të ndaj shumën prej 1000 eurove, ndërsa për shumë më të madhe vendos Kuvendi Komunal.

4. Nga shuma e mjeteve financiare të parapara me buxhet për Kuvendin Komunal mundë të ndahe: një shumë e caktuar si subvencion nga kryesuesi dhe grupet politike të përfaqësuara në KK, për nevoja ndonjë aktiviteti që lidhet me punën e kuvendit të komunës. E që shuma nuk mundë të jetë më e madhe se 2000 euro.

Neni 13

Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale:

1. Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësor të specialistit;
2. Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;
3. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera dhe
4. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme natyrore.

Neni 14

Ekzekutueshmëria e vendimit

1. Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve është i ekzekutueshëm nëse:
 - a) Nuk është paraqitur ankesë sipas nenit 9 pika 9 të kësaj rregulloreje
 - b) Me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa.
 - c) Në rastet e specifikuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Shpallja publike për ndarjen e subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në ueb faqen e komunës, mediat lokale, mediat sociale, vendet e frekuentuara, si dhe në çdo mjet dhe vend tjetër të përshtatshëm.
2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar në ndarjen e subvencioneve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregulloreje.
3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë pune nga data e shpalljes.
4. Afati i një shpallje publike për subvencione fillon që nga momenti kur publikohet në ueb faqen e komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

Neni 16

Marrëveshja për subvencionim

1. Kuvendi Komunal i përcakton sektorët (fushat) në të cilat bëhet ndarja e subvencioneve dhe i kategorizon ato sipas prioriteteve.
2. Për realizimin e subvencionit duhet lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes komunës dhe përfituesit të subvencionimit.

3. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, “përveç subvencioneve në fushën e shëndetësisë dhe ndihmës momentale”, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen.
4. Për rastet në fushën e shëndetësisë dhe ndihmës sociale përfituesit nënshkruajnë një deklaratë në momentin e aplikimit nëpërmes së cilës deklaron se mjetet e fituara do ti shpenzoi në mbulimin e shpenzimeve dhe nevojave për të cilat ka kërkuar.

Neni 17

Subvencionet për arsim

1. Komuna ndan subvencione për arsim në rast se ato parashihen në buxhetin komunal dhe me vendim të Kuvendit Komunal, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1 bursa për studentë,
 - 1.2 bursa për nxënës në shkolla të mesme,
 - 1.3 bursa për nxënës në shkolla fillore,
 - 1.4 kuadrot deficitare,
 - 1.5 nxënës me nevoja të veçanta,
 - 1.6 gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore),
 - 1.7 botimin e librave/ revistave,
 - 1.8 nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kuvendit Komunal për çdo vit fiskal.
3. Kryetari i Komunës përmes drejtotivë përkatëse dërgon arsyetimin për kategoritë dhe shumat e subvencioneve në Kuvendin Komunal i cili i shqyrton, ndryshon, miraton apo refuzon kërkesat e kryetarit për subvencionim.

Neni 18

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kriteret të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:
 - 1.1. Notën mesatare,
 - 1.2. Numri i studentëve/ nxënësve në familje,
 - 1.3. Kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë),
 - 1.4. Banimi në zona të thella rurale,
 - 1.5. Rezultatet në gara,
 - 1.6. Gjendja ekonomike.
 - 1.7. Drejtimi deficitar (caktohet me vendim të Kuvendit Komunal për çdo vit)

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1.Dokumenti i identifikimit
 - 2.2.Certifikata e notave
 - 2.3.Certifikata e vitit kalendarik të studimeve
 - 2.4.Certifikatë e vendbanimit
 - 2.5.Dëshmia mbi gjendjen ekonomike
 - 2.6.Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta
 - 2.7.Dëshmi për rezultatet në gara.
 - 2.8.Dëshmia mbi gjendjen ekonomike

3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë.

4. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në mediat lokale.

5. Poentimi për ndarjen e subvencioneve në arsim bëhet sipas kriterëve në tabelen e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi	Poentimi sipas kategorisë	Vërejtje
1	Nota mesatare	25 (pikë)	
2	Më shumë se një student në familje	10 (pikë)	
3	Zonat e thella malore (larg qendrës së qytetit)	5 (pikë)	
4	Gjendja ekonomike (rastet sociale)	15 (pikë)	
5	Drejtimi deficitar	25(pikë)	
6	Kategoritë e dala nga lufta	10 (pikë)	
7	Pa njërin prind	5 (pikë)	
8	Gjinia femrore	5 (pikë)	

Neni 19

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1.Zejet tradicionale
 - 1.2.Aksesore
 - 1.3.Agrobizneset
 - 1.4.Teknologji informative
 - 1.5.Ndërmarrjet publike
 - 1.6.Bizneset inovative
 - 1.7.Ndërmarrje sociale
 - 1.8.Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin
 - 1.9.Inkubatorët e biznesit
 - 1.10. “Start-up” bizneset
 - 1.11. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillimin e biznesit
 - 1.12. Aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.
2. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në komunë.
3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Neni 20

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi specifike në vijim:
 - 1.1.Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim
 - 1.2.Grave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevoja të veçanta dhe komunitetet
 - 1.3.Bizneset që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta 60% të vlerës
 - 1.4.Bizneset që posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale
 - 1.5.OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte biznesi të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës
 - 1.6.Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtit fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për zhvillim ekonomik të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donatorë tjetër.

2. Bizneset e përcaktuara në paragrafin 1.3 dhe 1.4 të këtij neni mund të aplikojnë për ndarje të subvencioneve edhe jashtë periudhës së shpalljes publike me kërkesë të arsyetuar.

Neni 21

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë duke mos u kufizuar:
 - 1.1.Plani i biznesit
 - 1.2.Dokumenti identifikues
 - 1.3.Certifikata e vendbanimit (për persona fizik)
 - 1.4.Certifikata e biznesit
 - 1.5.Dëshmi për pagesën e taksave komunale
 - 1.6.Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë
 - 1.7.Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së
 - 1.8.Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim)
 - 1.9.Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

Neni 22

Subvencionet në bujqësi

1. Komuna me vendim të Kuvendit Komunal në çdo fillim vit shpallë sektorët bujqësor me prioritet për tu subvencionuar dhe kategorizon fushat e subvencionimit.
2. Komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, për:
 - 2.1.Projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për komunën
 - 2.2.Organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studentore
 - 2.3.Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim
 - 2.4.Projekteve në sektorin e pylltarisë,
 - 2.5.Ndarjen e mekanizmave bujqësor,
 - 2.6.Ngritjen e serrave,
 - 2.7.Projekteve në fushën e pemëtarisë dhe perimtarisë,
 - 2.8.Projekteve në fushën e bletarisë.

3. Komuna publikon secilën thirrje për aplikim në ueb faqen zyrtare të saj dhe në tabelën e shpalljeve, dhe për secilën fushë të subvencionimit bujqësor, Komuna duhet të nxjerrë formularët e veçantë të aplikimit,
4. Komuna përmes Drejtorisë përkatëse duhet të organizoj takime publike me palët e interesuara për të shpjeguar detajet e konkursit dhe përmes këtyre takimeve shpjegohen kushtet, kriteret e aplikimit,
5. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:
 - 5.1.Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna
 - 5.2.Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim prej 25% të vlerës, në përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe.
 - 5.3.Grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe kategorive të dala nga lufta
 - 5.4.Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 23

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë:
 - 1.1. Numri identifikues i fermerit (NIF)
 - 1.2. Certifikata e biznesit, për ato të cilat janë të regjistruara.
 - 1.3. Projekti-propozimi dhe plani financiar (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti dhe agjenda e planifikuar, si dhe specifikimi i projektit).
 - 1.4. Fletëposedim për patundshmëri
 - 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale
 - 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë
 - 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj Komunës dhe ATK-së
 - 1.8. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
 - 1.9. Dokumenti identifikues i personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit.
 - 1.10. Dëshmi se nuk është përfitues i një subvencioni të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.
2. Dokumentet të cilat duhet dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Leternjoftimi i fermerit (Copy)
 - 2.2. Numri identifikues i fermerit (NIF)

- 2.3. Projektin dhe planin financiar
 - 2.4. Fletëposedimin për patundshmëri
 - 2.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale
 - 2.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë
 - 2.7. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.
3. Përfituesve të mekanizmave bujqësore u ndalohet shitja e mekanizmit bujqësor, së paku 2 vit pas përfitimit të mekanizmit bujqësor.

Neni 24

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndanë subvencione për banorët rezident për përballimin e shpenzimeve të shërimit sipas kritereve të përcaktuara nga drejtoria përgjegjëse për shëndetësi.
2. Subvencionet për shëndetësi jepen për:
 - 2.1. Rastet e rënda shëndetësore
 - 2.2. Rastet e sëmundjeve jo të rënda kronike por pa burim të të ardhurave
 - 2.3. Trajtimi jashtë vendit
 - 2.4. Fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik
 - 2.5. Mirëqenie sociale
 - 2.6. Strehim në Qendrën e Sigurt
 - 2.7. Gjendja e rend socio-ekonomike
3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 3.1. Numri i anëtarëve të familjes
 - 3.2. Çështja e banimit
 - 3.3. Kostoja e trajtimit
 - 3.4. Gjendja ekonomike familjare
 - 3.5. Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).
4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 4.1. Diagnozën e mjekut specialist
 - 4.2. Dokumenti i identifikimit
 - 4.3. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
 - 4.4. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore

- 4.5. Personat për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpallje publike por me kërkesë të arsyetuar.
5. Shuma prej 100 eurove për nënat lehona si formë subvencionimi ndahet sipas vendimit të Kuvendit Komunal që tashme është në fuqi.

Neni 25

Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Klubet sportive
 - 1.2. Sportistët e dalluar
 - 1.3. Garat sportive
 - 1.4. Shoqatat amatore (ansamblet)
 - 1.5. Teatrot amatore
 - 1.6. Festivalet
 - 1.7. 17 Shkurti dita e Pavarësisë
 - 1.8. 16 Qershori Dita e Clirimit
 - 1.9. Festivali folklorik "Oda e Llapushës"
 - 1.10. Botimi i librave
 - 1.11. Ekspozitat me fotografi
 - 1.12. Aktivitetet me karaktere garuese
 - 1.13. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
 - 1.14. Promovimi i librave
 - 1.15. Promovimi i talenteve të rinj
 - 1.16. Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS
 - 1.17. KVRL
 - 1.18. Qendra rinore.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 2.1. Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës
 - 2.2. Projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkesën, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme.
 - 2.3. Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.
3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- 3.1. Projekt propozimi
- 3.2. Aplikacioni
- 3.3. Dokumentet identifikuese
- 3.4. Certifikata e vendbanimi (për persona fizik)
- 3.5. Certifikata e regjistrimit (për persona juridik)
- 3.6. Dëshmi për pagesën e taksave komunale
- 3.7. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik)
- 3.8. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)
- 3.9. Konfirmimin nga banka për xhirologarinë e aplikuesit.

Neni 26

Vlerësimi i aplikacioneve në aspektin procedural

Brenda pesë (5) ditëve nga data e mbylljes së thirrjes publike, komisioni Vlerësues bënë hapjen e çdo aplikacioni, nëse ato i plotësojnë kriteret formale, duke përfshirë kriteret e paraqitura në këtë rregullore.

Neni 27

Parandalimi i konfliktit të interesit

1. Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, komuna duhet të sigurojë që të mos ekzistojë konflikt i interesit i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
2. Komuna si mbështetëse financiare duhet të sigurojë shmangien e çfarëdo konflikti të interesit me rastin e marrjes së vendimit për aplikacionet.
3. Anëtarët e komisionit vlerësues, përkatësisht të komisionit të ankesave duhet paraprakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këto komisione është në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt i interesit.
4. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtarët duhet të kërkojnë nga udhëheqësi zëvendësimin e tyre.
5. Anëtari rezervë i komisionit zëvendëson anëtarin i cili tërhiqet për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesit.

Neni 28

Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna, “përjashtim në fushën e shëndetësisë, ndihma momentale dhe bursave në arsim”, obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj).
3. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe komunës apo në vendimin e Kryetarit të Komunës.
5. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokolohehen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.

Neni 29

Drejtoritë komunale të fushave përkatëse në të cilat ndahen subvencione, përgatisin raporte për Kuvendin Komunal dhe raportojnë për secilën fazë të projektit të subvencionimit, duke ofruar dokumentacion përkatës, ku përfshihen:

1. Listën e aplikuesve dhe dokumentet përcjellëse sipas kritereve të paraqitura në shpallje
2. Dokumentet e komisionit përzgjedhës dhe kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes të aplikuar
3. Listën e aplikuesve për subvencione
4. Listën e përfituesve me poenët apo pikët e marra, përfshirë fshatin prej nga vijnë ata
5. Si dhe çdo dokument tjetër relevant që ka të bëjë me shpalljen e projektit për ndarje të subvencioneve.

Neni 30

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Për secilën kontratë të lidhur, Komuna cakton një zyrtarë përgjegjës i cili duhet kujdesët për monitorimin e implementimit të projektit. Komuna mund të formojë edhe ekip për këtë qëllim.

2. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.
3. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.
4. Monitorimi sipas paragrafit 1 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfitimit të subvencionit.
5. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës nga përfituesit, zyrtari/ekipi monitorues raporton në drejtorinë përgjegjëse komunale, duke rekomanduar për hapat e mëtejme. Masat e propozuara duhet të jenë procedurale me shkeljen e bërë nga përfituesi.
6. Në rastet e shkeljeve të rënda të kontratës, Kuvendi Komunal mund të nxjerrë vendim për anulimin e kontratës dhe masa për inicimin e procedurave gjyqësore përkatëse.

Neni 31

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën e aplikuesëve dhe dokumentet përcjellëse sipas kriterëve të paraqitura në shpallje.
2. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari
3. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbaj: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni, fshatin-vendbanimin prej nga vijnë përfituesit, si dhe shumat që iu janë dhënë përfituesve.
4. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2,7 të nenit 24.
5. Publikimi i vendimeve dhe përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.
6. Për secilin lloj të subvencionit bujqësor Komuna duhet të bëjë shpallje të veçantë publike dhe krahas kësaj duhet të vendos kriteret bazë për aplikim.
7. Komuna përmes drejtorive përkatëse është e obliguar të ofroj informacione lidhur me procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe mënyrat e aplikimit për secilën palë të interesuar.

Neni 32

32.1 Kryetari i Komunës përmes drejtorive përkatëse është i obliguar që të krijoj një databazë ku përfshihen të gjitha të dhënat për të gjitha kategorit e ndarjes së subvencioneve,

përfituesit dhe të dhënat tjera relevante. Kjo databazë i shërben Kuvendit Komunal që të ketë orientimin e duhur të subvencioneve dhe vlerësimin e tyre për secilin vit më radhë.

32.2 Në rast të identifikimit që individi ka qenë përfitues i të njëjtit subvencion më parë i anulohet përfitimi i subvencionit të njëjtë në vitin pasues, përjashtim bëhet këtu për kategori të caktuara të subvencionit siç janë: farërat, plehurat, etj.

Neni 33

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

1. Komuna lidhë kontratë me përfituesit e subvencioneve në mënyrë që çdo shkelje e kontratës, nga të dy palët të sanksionohet.
2. Përfituesi i subvencionit nuk mund ta shes, ta tjetërsoj, apo ta keqpërdor në çfarëdo forme tjetër subvencionin e përfituar.
3. Kuvendi Komunal vendosë për themelimin e Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Ekonomik dhe në fushat tjera në të cilat ndahen subvencione.
4. Komisionet e themeluara hartojnë formularët e veçantë të aplikimit për secilën fushë të subvencionit.
5. Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse obligohen që ti sjellin Kuvendit Komunal një databazë ku përfshihen të gjitha subvencionet e ndara nga komuna dhe përfituesit e tyre që nga viti 2010 e deri me tani.
6. Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vazhdon me rregulloren ekzistuese pavarësisht nëse kjo rregullore hynë në fuqi.
7. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja paraprake.
8. Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Malishevës.

Neni 34

Ndryshimi dhe Plotësimi

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me propozimet e arsyetuara nga propozuesi.

Neni 35

Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës.

Neni 36

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet rregullorja nr.02/244 datë: 09.09.2015

Neni 37

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 1227

Datë: 01.07.2020

Kryesuesi i Kuvendit

Brahim Morina

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 178

Datë: 03.06.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 pika a,c, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 13 paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/20018 për Transparencë në Komuna, nenit 7 paragrafi 1, pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/20018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, në bazë të nenit 10, nenit 12 paragrafi 1,2, nenin 19 paragrafi 7 pika e, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së - III- (tretë) të mbajtur me datë: 01.06.2020 merr këtë:

V E N D I M

PËR PARAQITJEN NË DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT RREGULLORES PËR NDARJEN E
SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE

1. Miratohet vendimi për paraqitjen në debat-konsultim publik të draft-Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transferëve.
2. Diskutimi publik paraqitet në afat prej 14 ditëve, nga dita e shpalljes-paraqitjes së ftesës në tabelën e shpalljeve publike të Komunës së Malishevës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet në Komunën e Malishevës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

